

VENDIM
Nr. 591, datë 1.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR ZHVILLIMIN E NJË
PROJEKTI KONCESIONAR NË ZONAT PLAZH DHËRMI DHE PLAZH PERIVOLL, ME
KARAKTER TURISTIK, PANORAMIK DHE INFORMUES, NDËRTIMIN E
INFRASTRUKTURËS PËRKATËSE DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “EUROKONTAKT”, SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për zhvillimin e një projekti koncesionar në zonat plazh Dhërmi dhe plazh Perivoll, me karakter turistik, panoramik dhe informues dhe ndërtimin e infrastrukturës përkatëse është bashkia Himarë.
 2. Projekti shtrihet në zonën gjeologjike të përcaktuar sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Miratimin e bonusit prej 2% (dy për qind) të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Eurokontakt”, sh.p.k.
 4. Ngarkohet bashkia Himarë me zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha